



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-31239/24
Kaçanik, 20.12.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XI (njëmbëdhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VIII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 20.12.2024, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarët-të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rrustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Edona Luzha.

Nga Ekzekutivi i Komunës fillimisht ishte në mbledhje ishte Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, por për shkak të një takimi tjetër, nuk pati mundësi me qendruar në mbledhje të KPF. Pjesëmarrës nga Ekzekutivi: Nënkryetari-Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Qamil Stagova-DUKMM, Suhad Dullovi-DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP. Nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Mavije Murseli, Makfire Malsiu.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësi, konstatoj kuorumin, pastaj e hapi mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të rregullt të KPF-së për vitin 2024, data 20 dhjetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut;
3. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së Veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025 nga lista e përgjithshme e pronave komunale;
4. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë;
5. Propozim Vendimi për Arovimin e Planit të punës i Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;
6. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit;
7. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave të demolimit të objekteve ndërtimore (mbeturinat inerte).

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së X (dhjetë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 26.11.2024/ Lënda: 01Nr. 60/01-29266/24.

2. Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje ka ardhur në bazë të kërkesës së BI dhe të nevojave të qytetarëve, për me i rritur shërbimet e varrimit dhe shumën e mjeteve. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Me kërkesën e re të BI, unë nuk po mundem me kuptuar se cilat janë shërbimet të cilat janë rritur, përveç rritjes së çmimit. Nuk e di qysh i kanë komunat tjetra këto shërbime, se është një barrë bukur e madhe e komunës, se po rritet shuma nga 170€ në 300€. Ndërkaq në anën tjetër, pa të keqën e askujt, por ne paguajmë edhe anëtarësi, se këtu po thuhet se kjo nuk i liron qytetarët nga pagesa e anëtarësisë. Cili është dallimi atëherë?

Kryesuesi i Kuvendit: Në vendimin e mëhershëm nuk ka qenë shërbimi: hapja dhe mbulimi i varrit. Kategoritë tjera të cilat kanë qenë të përfshira, tani është rritur kostoja e shërbimeve, e kanë një levizje të lehtë të ngritjes, por me tepër e ka ngritur shumën shërbimi: Hapja dhe mbulimi i varrit, se shumë lokalitete po kanë problem me gjetur njerëz me i kryer këto shërbime. Shumica e komunave e kanë këtë shërbim, mendoj se është e arsyeshme me u përfshirë në kuadër të këtyre shërbimeve. Janë shërbime që e prekin direkt qytetarin, ndoshta në momentet me të vështira që kalon. Pjesa tjetër, të çështja e anëtarësisë, kur nuk kemi pasur vendim, BI i kushtëzonte qytetarët që nëse nuk e ka paguar anëtarësinë, mos me iu paguar shërbimin. Tani nuk ka të drejtë me këtë vendim me i kushtëzuar qytetarët, është çështje tjetër BI qysh e mbledhë anëtarësinë. Ky shërbim është një lehtësim i madh për qytetarët, besoj se duhet me u përkrahur.

z. Rrustem Zenuni: Me vjen mirë që ka pasur mirëkuptim prej komunës, edhe pse ka kosto mbulimi i këtyre shërbimeve, se shërbimet për hapjen e varrit po janë shumë problem, se nuk mundem me gjetur njerëz me i krye këtë shërbim. E mbështeti Propozim Vendimin e drejtorisë, por çështja është: Nëse kemi të bëjmë me ndonjë komunitet tjetër, qysh trajtohet mbulimi i shërbimeve të varrimit?

znj. Kadrije Lika-Troni: Edhe unë e mbështeti këtë vendim, se mbulimi i këtyre shërbimeve, ua lehtëson qytetarëve kur ballafaqohet me dhimbjen e anëtarit. Pyetje për drejtorin: Në zonat rurale në kohërat e dimrit, qysh shkon çështja e hapjes së varrit, qysh bëhet organizimi, a ka me pasur ndonjë rregullore, a ka me pasur ndonjë operator, qysh bëhet njoftimi i familjes kur është e shtunde apo e diel, qysh është procedura?

znj. Ardita Rrahmani: Vendimi për mbulimin e shërbimeve të varrimit është, unë jam duke diskutuar për çmimin, se shërbimet janë që 4 vite, jam me diskutuar vetëm çështjen e çmimit, se sa kam informata, BI në Kaçanik ka bërë kërkesë për një çmim me të madh, diku 350€, mandej në komunikim ka zbritur shuma në 300€. Nuk jam kundër vendimit, se e di se është nevojë e lokaliteteve për këto shërbime.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi ka qenë i vitit 2020, kostoja është rritur me shtimin e shërbimeve, dhe rritjes se kostos, si rritja e çmimit të naftës. Sqarime me të hollësishme na jep drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

z. Ramadush Osmani: Kërkesa është nga BI, është shtuar edhe shërbimi i hapjes së varrit, janë bërë 8 shërbime, prej tyre 4 nga shërbimet nuk janë ndryshuar. Pas këtij vendimi, ne zakonisht kemi marrëveshje me BI. Pastrimi i të vdekur nga 45-50€, transporti nga 40-70€, drrrasat nga 20-30€. Shërbimi, hapja e varrit 80€, kjo është diferenca që e ka ngritur çmimin. Në aspektin financiar është e përballeshme, se 60 mijë euro janë subvencione të drejtorisë. Sivjet është sjellë diku 40 mijë euro në total shpënzimet. Në vitin 2023, nuk ka qenë hapja e varrit. I kemi pyetur edhe komunat tjera, Hani i Elezit e ndan shumën 250€, pa shërbimin për hapje të varrit. Ferizaji, 320€ me hapje të varrit. E mira e kësaj është se po i ndihmojmë qytetarit, jo BI, se po ia kryejmë një shërbim në momentet kur ka nevojë me së shumti familja, se duke parë levizjet e fundit, nuk ka njerëz për hapje të varrit. Të pyetja e Kadrijes, është çështje e BI sesi e organizon, a ka kompani apo ka punëtorë BI apo si e organizon hapjen e varrit, sepse BI neve na e sjellë raportin se janë kryer shërbimet. Të konfeksionet tjera që e potencoj Rrustemi, nëse ka raste të tilla, mjetet i procedohen direkt familjes.

Kryesuesi i Kuvendit: A bënë me shtuar një nen për raste tjera mbulimin e shpënzimeve për raste të fesë tjetër. Çështja është së MAPL mundet na kthyer vendimin, se mundet me ndodhë me pasur ndonjë rast. Nëse raste të feve jomuslimane, shuma e mjeteve i dërgohet direkt familjes, se nëse e lëmë kështu, është antiligjore dhe antikushtetuese, se Kosova ka barazi fetare.

z. Kadri Krivenjeva: Pajtohem edhe unë që pasuesi për mbulimin e shpënzimeve të feve tjera, të specifikohet në Propozim Vendim.

znj. Ardita Rrahmani: Edhe unë pajtohem se duhet të përfshihen edhe mbulimi i shpënzimeve të varrimit të feve tjera.

z. Ramadush Osmani: Mundem me rregulluar me financa, se nuk e di a pengon kjo, se këto mjete janë subvencion. Deri me tani nuk është paraqitur asnjë rast. Si vendim nuk është antiligjore, rasti kur e subvencionojmë atë familje, duhet me shikuar se a është pagesë ligjore. E analizojmë këtë çështje, se mbi mënyrën e ekzekutimit të këtij vendimi, lidhet marrëveshja, kështu në marrëveshje ne mundemi me cekur këtë çështje.

z. Agim Mani: Pajtohem me drejtorin, se këtu bëhet një marrëveshje me BI, e cila bazohet në këtë vendim. Komuna mundet me lidhë një marrëveshje tjetër, për mbulimin e shpënzimeve të varrimit për fetë tjera, se kërkesa ka rrjedhë nga BI, e ne nuk mundem me ndryshuar kërkesën e BI.

z. Ramadush Osmani: Mos të komplikojmë këtë çështje konsultohem me ligjin. Ne me këtë vendim po dakordohemi për mbulimin e shpënzimeve të rasteve mortore të komunës së Kaçanikut. Edhe konfeksionin e mbulojmë me 300€. BI i ofron shërbimet për të vdekurin, ndërkaq për ata të feve tjera, të njëjtën shumë 300€ e japim.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne jemi duke marrë vendim, ne nuk jemi duke lidhur marrëveshje. Ti përfshijmë të gjithë, qysh i kemi përfshirë të pika 3, të rastet mortore të kategorisë së veteranëve

të luftës, përfshihet kompenzimi shtesë 175€. Asgjë nuk na pengon për ratet mortore të feve tjera, më shënuar që vlera e mjeteve i jepet familjes.

znj. Kadrije Lika-Troni: Si të aneks kontrata, a mundem me ia shtuar këtij vendimi një aneks vendim?

Kryesuesi i Kuvendit: Jo nuk mundem, mundem me një pikë të vendimit me shënuar këtë çështje.

z. Agim Mani: Drejtor, unë e kam një kërkesë të çështja e transportit, kur të bëni marrëveshjen me BI, është mirë me specifikuar me qartë, se unë kam pasur probleme se kemi familjarë jashtë, kufoma po shkon në xhami dhe BI po e kryen vetëm një transport, jo dy.

z. Ramadush Osmani: Kjo është ngritur në debat nga BI, sepse po ka një kosto shtesë, se kufoma po dërgohet të morgu, pataj familja po kërkon me sjellë në shtëpi, ndërkaq është planifikuar me marr nga familja deri të varri.

Kryesuesi i Kuvendit: Trajtoje këtë çështje drejtor, se neni 1 të obligon për mbulimin e shpënzimeve për të gjithë qytetarët e komunës së Kaçanikut.

z. Ramadush Osmani: Unë kam qenë i kujdesshëm të anëtarësia, e kam potencuar se ky vendim qytetarët nuk lirohen nga pagesa e anëtarësisë, as nuk mund t'i kushtëzoj për mos me ua kryer shërbimet e varrimit, se edhe ata të feve tjera paguajnë anëtarësi.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për me ia dërguar KK, me ndryshimin që me shtuar një nen për raste tjera mbulimin e shpënzimeve për raste të fesë tjetër, në shumën 300€, dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Propozim Vendim për financimin e shpënzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendim për Arovimin e Listës së Veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025 nga lista e përgjithshme e pronave komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: Të kjo pikë, e dimë që është obligim ligjor që në çdo fundvit të listohen pronat komunale dhe të bëhen publike në faqe të komunës, për me pa nëse ka kush interesim për këto prona. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Pronat komunale i keni ndarë në 2 grupe, lista e përgjithshme dhe lista e veçantë. Nëse mundet drejtori me na sqaruar pse janë ndarë në 2 grupe pronat komunale, se nëse për listat e veçanta, ka pasur kërkesa të mëhershme, pse nuk janë realizuar në këtë vit. Cili është qëllimi që janë ndarë pronat në këtë formë?

z. Qamil Stagova: Juristin të cilin e kam në drejtori, me ka thënë se duhet me i listuar pronat komunale në këtë formë. Në listën e përgjithshme janë të gjitha pronat e komunës, ndërkaq në listën e veçantë janë pronat që planifikohen me u dhënë në shfrytëzim gjatë vitit vijues, në bazë të kërkesave apo planeve të komunës. Nga lista janë larguar pronat që janë dhënë në shfrytëzim.

znj. Kadrije Lika-Troni: A ka pasur mundësi drejtor me u specifikuar për kohën e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, 15 vite, 20, 40 apo 99 vite? Nëse ne bazohemi në PZHK, janë disa prona që nuk munden me u dhënë në shfrytëzim për 99 vjet.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është për publikim, pastaj edhe 2 herë del në KK, merret vendimi paraprak, formohet komisioni vlerësues, pastaj vendimi për me dhënë në shfrytëzim. Ne nuk mundemi tani me përcaktuar kohën, se mundemi me gabuar, se ne mundem me dhënë për 99 vite, por mundet mos me pasur të interesuar për atë pronë, por për një pronë tjetër. Pronat e caktuara munden me u dhënë në shfrytëzim në bazë të shprehjes së interesit.

z. Agim Mani: Të çështja e ndarjes së pronave, si keni mundur me i listuar me prioritet të lista e veçantë?

z. Qamil Stagova: Pronat të vogla, pronat që janë të ndërtuara, i kemi hequr nga lista. Në listën e përgjithshme janë të gjitha pronat e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Lista e përgjithshme është për krejt pronat. Edhe ku ka ndërtime të objekteve të komunës etj.

z. Agim Mani: Ku jeni bazuar që e keni nxjerrë listën e veçantë?

znj. Kadrije Lika-Troni: Çfarë veçorishë ka lista e veçantë?

z. Qamil Stagova: Qëllimi si qëllim, është se munden me u dhënë këto prona në shfrytëzim në vitin 2025. Lista e veçantë bëhet çdo vit, pronat që janë dhënë, janë larguar nga lista e veçantë.

znj. Kadrije Lika-Troni: D.m.th. lista bëhet në bazë të kërkesave që i keni ju?

Kryesuesi i Kuvendit: Në listën e veçantë, janë pronat që mund të jepën në shfrytëzim në vitin 2025. Lista e përgjithshme, është me të gjitha pronat e paluajtshme të komunës. Për me dalluar këtë listë, është bërë lista e veçantë, që me ditur se këto prona janë në dispozicion me i dhënë në shfrytëzim.

z. Agim Mani: Në listën e pronave të përgjithshme, ka edhe prona tjera që munden me u dhënë në shfrytëzim. Për atë unë kërkoja me ditur si është krijuar lista e veçantë.

z. Rrustem Zenuni: Në listën e përgjithshme, nuk duhet të jenë pronat që janë ndërtuar shkolla, apo oborri i tyre, oborret e ambulancave, këto prona duhet me u largua nga lista. Ne kemi prona të komunës që mundemi me i shfrytëzuar për aktivitete sportive, etj.

Kryesuesi i Kuvendit: Të kemi të qartë që i kemi 2 lista. Në listën e përgjithshme, është çdo pronë e lirë e komunës, që me iu dhënë munësinë njerëzve me shprehur interes.

znj. Ardita Rrahmani: Për të ardhmën, të mbetet si propozim që në faqën e komunës të jenë e pbliguar lista e pronave komunale me skica, se qasja në gjeoportal për shumë qytetarë është e vështirë, se nuk e dinë me i shikuar pronat në gjeoportal.

z. Suhad Dullovi: Ai investitor që don me investuar, i ka njerëzit e shkolluar që i kuptojnë dhe bëjnë zgjidhje.

Kryesuesi i Kuvendit: Publikimi i listës është obligim ligjor. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendim për Arovimin e Listës së Veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025 nga lista e përgjithshme e pronave komunale. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini, nga vizita e realizuar në Turqi, ka rezultuar me lidhjen e një marrëveshje për binjakëzim – apo me ligj quhet, marrëveshje për bashkëpunim ndërkomunal ndërkombëtar. Nësmat duhet të miratohen nga 2 kuvendet komunale. Ne e kemi në shqyrtim nismën në këtë mbledhje. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Është mirë që vizita e realizuar, ka produktivitet dhe rezultat pas saj. Pavarësisht se çka vjen pas saj, vjen si urë e mirë, për bashkëpunim në fushën e arsimit apo në fusha tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Mua me është lajmëruar Regjepi, se nëse pak do ti iepët mundësia, do të jetë në mbledhje të KK. Regjepi është një shqiptar që jeton në Turqi shumë i suksesëshëm, dhe që ka autoritet në komunitetin e Bursës, i dekoruar nga shteti Turk, në luftën e Qipros. Besoj se do të jetë ai këtu. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimi për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për Arovimin e Planit të punës i Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Ne si komision e kemi mbajtur një takim, disa kanë marrë pjesë disa jo. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Unë nuk kam qenë i njoftuar për mbledhje të komisionit për hartimin e Planit të punës së KK, kjo është arsyeja që nuk marrë pjesë, ndoshta në email zyrtar me ka ardhur, por nuk është duke funksionuar adresa.

Nga Zyra zyrtarët që punojnë punë të KK, u vërtetua se z. Agim Mani i është dërguar ftesa për mbledhje të komisionit në dy adersat e tij.

Kryesuesi i Kuvendit: Konsultone me IT se për shkak të sigurisë, duhet me i ndërruar pasvordin emailit zyrtar.

z. Agim Mani: Kërkoj falje, se nuk e kam pa ftesën për mbledhje të komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqë nuk ka kush diçka për diskutim, e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimi për Arovimin e Planit të punës i Kuvendit të Komunës, për vitin 2025. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit;

Kryesuesi i Kuvendit: Është një raport që duhet me u njoftuar kryetari dhe ministria, por mirë është që ka me u diskutuar në KK, për me dituar sa është plotësuar kriteri i një fushe të caktuar të performancës. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, raporti u shtrua në votim për me ia përcjellë KK dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se **KPF**

diskutoj Raport për zbatimin e Planit të Integritetit. Ky raport i përcjellët Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

7. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave të demolimit të objekteve ndërtimore (mbeturinat inerte).

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, është një çështje që jo vetëm komuna jonë, por edhe çdo komunë tjetër kanë telashe për deponimin e këtyre mbeturinave inerte. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Është me u përshëndetur kërkesa e një qytetari për me lëshuar tokën për mbeturina inerte. Këtu po thuhet se është një marrëveshje e veçantë, mua po me intereson me ditur se ky e ka ofruar pronën, por çka ka kërkuar? Unë nuk po e njoh se kush është ky person.

z. Ramadush Osmani: Marrëveshja e veçantë do të lidhet se qysh me menaxhuar atë deponi.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne marrim vendim për caktim të lokacionit, ndërkaq pjesa tjetër është procedurë tjetër. Ai mundet me i përpunuar ato mbeturina, askush nuk e ndalë. Neve na intereson si lokacion për depionimin e mbeturinave, kosto nuk besoj se kemi me paguar. Koston besoj se e paguajnë kompanitë, por a ia paguajnë komunës apo personit, nuk e di, nëse është pronë private, besoj se ia paguajnë personit.

z. Rrustem Zenui: A është pjerrtësi lokacioni i propozuar?

znj. Ardita Rrahmani: Jo nuk është pjerrtësi lokacioni.

Kryesuesi i Kuvendit: Sido që të jetë, lokacioni është pronë private, mundet të jetë edhe livadh.

znj. Kadrije Lika-Troni: Sa e lexova, lokacioni për mbeturina është një pjesë pjerrtësi, mbeturinat inerte janë të forta dhe të rënda. Desha me pyetur drejtorin: A është konsultuar me ndonjë ekspert të fushës, se aty mundet me pasur shëmbje të dheut dhe probleme tjera? Prej mbetjeve inerte, a është planifikuar me u hedhur aty edhe azbesti se edhe kjo është mbetje inerte? A ka ndonjë kërkesë apo ide sesi me i zhdukur mbetjet e azbestit, se kjo mbeturinë paraqet probleme shëndetësore në mjedis,? Unë mendoj se duhet me i klasifikuar mbetjet inerte që hedhën aty.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë nuk e di ku është lokacioni, por sido që të jetë, kjo mundet me pasur pasoja në aspektin teknik dhe shëndetësor. Besoj se drejtoritë e kanë studjuar këtë çështje, se deponimi i mbeturinave bëhet me kamion të mëdhënjë dhe nëse është rrugë lokale, mundet me u shkatërruar edhe rruga. Besoj se është planifikuar edhe kjo çështje, se realisht nuk lejohen me ecur kamionat me peshë të rëndë 20 ton në atë rrugë.

z. Qamil Stagova: Lokacioni aty nuk është veç me pjerrtësi, një pjesë është si luginë dhe mundet me u bërë një plan i mirë për deponimin e mbeturinave inerte. Rruga që është Kaçanik-Stagovë, nuk kemi aty ndonjë shenjë që e kufizon ndalimin e qarkullimit të automjeteve që bartin pesha të rënda.

Kryesuesi i Kuvendit: A e dini sa është trashësia e rrugës aty?

znj. Ardita Rrahmani: Kufizim nuk ka, por gjatë ndërtimit të hekurduës, u dëmtua rruga për Stagovë. A po e shihni se krey po ndërlidhën çështjet, tani dalim të kualiteti i asfaltit. Unë në atë pjesë e kam shtëpinë, nuk ka drita ende, ndërkaq çka nëse edhe asfalti prishet tani nga kamionat që bartin peshë të rëndë?

Kryesuesi i Kuvendit: Rrugën e ka për obligim me mirëmbajtur, por sido që të jetë, e zgjidhë një problem me të madh, që mundet me na shkaktuar probleme me të mëdha, se mbeturina ka kudo, kështu që qëllimi është më i mirë.

z. Rrustem Zenuni: A duhet me pasur ndonjë pëlqim ai për atë lokacion, se ajo pjesë është mal, se për ne mundet me u bërë zgjidhje, por për dike mundet me qenë pengesë?

Kryesuesi i Kuvendit: Në momentin që drejtorja e ka sjellë propozimin, drejtorja e jep edhe pëlqimin mjedisor.

z. Ramadush Osmani: Para se me dal me Propozim Vendim, është formuar komisioni, i cili i ka analizuar këto detaje.

z. Qamil Stagova: Nuk po e përjashtoj këto çështje, ata janë të pavarur, afati nuk është caktuar, besoj se ai ka me pasur marrëveshje që në fund me kthyer atë vend në gjendje të mëparshme.

z. Rrustem Zenuni: E vërtetë, por nuk po ndodhë me u kthyer lokacioni në gjendje të mëparshme.

z. Sabedin Vishi-Nënkryetar i Komunës: Kjo kërkesë për lokacion, është i mirëseardhur, se është bukur vështirë me gjetur një pikë për deponimin e mbeturinave inerte. E përmendi edhe drejtori që fillimisht ka dal komisioni, e ka analizuar atë lokacion. Kam qenë edhe unë e kam vizituar atë lokacion, lokacioni është të pjesa pa mbrri ende të varrezat e qytetit, është një humnerë bukur e madhe, shtëpitë nuk i rrezikon, ndërkaq nëse na lejohet ky lokacion, atëherë duhet me hyrë në marrëveshje për deponimin e mbeturinave inertet. Me marrëveshje me rregulluar si me u monitoruar deponia, e jo me hedhur çfardo mbeturine aty. Është mirë që po bëhet kjo, se jemi penalizuar për këtë çështje, se në mungesë të lokacionit, mbeturinat po hedhën kudo. Nëse na vjen ligjore, ne duhet me lidhur marrëveshje me palën, që në fund me u mbuluar kur të mbushët. Çështjen e infrastrukturës i takon komunës, asfalti nuk besoj që është aq i dobët, besoj se është paramenduar edhe për qarkullimin e automjeteve me pesha të rënda edhe kjo pjesa kah Dushkaja. Në pjesën prej ku e lëshojmë asfaltin deri të lokacioni, ajo pjesë don trajtim të veçantë në vazhdimësi qysh e bëjmë marrëveshjen, duke e rrafshuar dhe mbushur në vazhdimësi dhe me i mbuluar mbeturinat. Kjo marrëveshje duhet të definohen që mos me hedhë mbeturina që janë të rrezikshme për qytetarë. Nëse arrihet me u realizuar, mendoj se është një prej vendimeve me të mira. Nuk është që nuk kemi shikuar edhe lokacione tjera.

znj. Kadrije Lika-Troni: A ka qenë kjo një thirrje prej komunës se kush ka prona për lokacion për mbeturina, apo ka qenë kërkesë e një qytetari dhe ju e keni aprovuar.

Nënkryetar i Komunës: Ka kohë që ne kemi qenë të interesuar për lokacion, kemi shikuar në Semajë, pala e ka marrë informacionin se jemi të interesuar me gjetur një pikë për lokacion, dhe atij i konvenon se mbushet ajo pjesë, se në të ardhmën mundet me shfrytëzuar për ndërtim apo diçka tjetër.

znj. Kadrije Lika-Troni: A ka me qenë ky lokacion për afatgjatë apo afatshkurtër?

Nënkryetar i Komunës: Ka me qenë për afatgjatë, se sipërfaqja është bukur e madhe.

znj. Ardita Rrahmani: Sipërfaqja është diku gati 1 ha.

z. Kadri Krivenjeva: Sipërfaqja është diku 1 ha.

Kryesuesi i Kuvendit: Kur të lidhet marrëveshja, duhet me qenë të kujdesëm me i definuar gjërat, se nuk mundemi me i dërguar 3-4 kamion dhe me lënë veç me ia bërë kontratën. Marrëveshja duhet të jetë për një periudhë kohore, që mos me pas të drejtë për atë periudhë me u hedhur mbeturinat e ngurta diku tjetër.

znj. Ardita Rrahmani: A na vjen marrëveshja në KK?

Nënkryetar i Komunës: Marrëveshja sipas të gjitha gjasave vjen në KK, aty duhet me qenë në syqelë edhe ne edhe ju si opozitë.

Kryesuesi i Kuvendit: Aty duhet me u caktuar një kosto, se ai që e dërgon mbeturinat, ka me bërë një pagesë.

z. Ramadush Osmani: Faza e parë është me caktuar lokacionin, deponuesit ilegal ka të drejtë inspekcioni me i gjobitë, se tani nuk po kemi të drejtë, se nuk kemi deponi. Ne, pas kësaj në rregulloren e taksave komunale kemi me futur taksën për deponimin e materialit të ngurtë. Në bashkëpunim ne kemi me caktuar tarifën për kubik në KK, që e paguan deponuesi. Pastaj ai a e gjeni një kompani, apo kompania "Pastëria" çështja sesi menaxhohet, se këtu deponohen ndërtimet e rënimëve të objekteve, blloka, etj, mbushet pastaj shtresa me dhe.

znj. Ardita Rrahmani: Fatmir Berishën duhet me falenderuar për lokacionin e ofruar për deponi, për këtë meriton një mirënjohje nga komuna.

z. Rrustem Zenuni: Ne po shpresojmë se kjo ka me kaluar pa problem në KK, besoj edhe në ministri, por çështja është me u bëhet marrëveshja, me u bërë falë hedhja e mbeturinave prej operatorëve, se është interes i palës, se edhe neve na konvenon, se ai është duke e mbushur për veti atë lokacion, jo për ne.

znj. Ardita Rrahmani: Unë nuk jam për me u deponuar aty mbeturinat pa para, se ne jemi duke paguar me i hequr mbeturinat e grumbulluara, ndërkaq në anën tjetër ai e ka lëshuar atë lokacion, se ai lokacion komunës i kryen punë, pavarësisht qëllimit të tij, se po të pastron ambientin.

Nënkryetar i Komunës: Komuna po paguan mjete me i hequr mbeturinat ilegale.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja e taksave, është e rregulluar me një rregullore të ministrisë. Ai nuk përfiton nga taksat, se ai shpenzon në mirëmbajtje.

z. Ramadush Osmani: Pala nuk përfiton nga ajo taksë, se shpenzon për mirëmbajtjen e deponisë.

z. Rrustem Zenuni: Ne kemi shumë gurthyes që e kanë shkatërruar lokacione, dhe nuk e kanë kthyer në gjendjen e mëparshme.

znj. Ardita Rrahmani: Ne po flasim për një diçka që i takon komunës, ndërkaq çështja e gurthyesës është në kompetencë të ministrisë. Nuk po me pëlqen mendimi i juaj, se ne jemi këtu me i diskutuar këto çështje.

z. Qamil Stagova: Mbeturinat që krijohen nga ndërtimet, dhe demolimit të objekteve të vjetra, ai duhet me i menaxhuar, e me i mbuluar dhe mos me lënë me u hedhur mbeturina jo të ngurta.

z. Rrustem Zenuni: Nënkryetar unë e kam një shqetësim tjetër. Me 17 korrik 2023, nuk e di a jeni të informuar në Ferizaj, afër Mileniumit, ka qenë Burimi Compani -Eurotransi tash, ata e kanë pasur një marrëveshje me një biznesmen gjerman dhe belg, me u ndërtuar fabrika me e madhe në ballkan për deponim e të gjitha llojeve të mbeturinave, ku parashihet edhe kjo mbeturinë. Kjo nuk është bërë, për shkak se është pezulluar leja prej ministrisë. Kjo ka qenë e mirë, se ishin bërë edhe punësime, diku 30 milion euro ka pas me kushtuar projekti. Desha me ditur a ka qenë e informuar komuna për këtë çështje?

Nënkryetar i Komunës: Jemi duke folur për mbeturina inerte-të forta, se këto mbeturina nuk mund të hynë në atë grup të mbeturinave. Ne jemi duke folur për mbeturinat që nuk mundën me u ricikëluar.

z. Rrustem Zenuni: Aty ka pasur me u ndërtuar një guthyes, ku ishin ricikluar mbeturinat inerte, se me ka interesuar kjo çështje.

z. Agim Mani: Unë mendoj se kjo çështje duhet me pasur qartësi. Ne jemi duke folur për një operator privat, e jo shtetëror apo publiko privat. Ky ka shpreh dëshirë me hapur një deponi të tillë, e jo komuna, e ka ofruar këtë mundësi komunës. Marrëveshjen ka me bërë me komunën,

duhet me pasur parassysh me iu përmbajtur marrveshjeve që ka me i bërë me komunën. Çka përfiton komuna në këtë rast, zero.

z. Rrustem Zenuni: Komuna përfiton se e zgjidhë një problem të madh.

z. Ramadush Osmani: Komuna përfiton, se 30 mijë euro në vit po shpënzohet për buxhet për heqjen e mbeturinave ilegale.

z. Agim Mani: Çështja se, a është lokacioni i qëlluar? Kjo duhet me u diskutuar, se ka lokacion afër këtij lokacioni që është pronë komunale, 200-300 metra nga ky lokacion ka shtëpi.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nëse ka vendbanim afër, nuk duhet me aprovuar këtë lokacion.

znj. Ardita Rrahmani: Shtëpitë e banimit janë me larg lokacionit.

z. Agim Mani: Unë e di atë pjesë me mirë, se jam rritur aty. Lokacioni është përtej varrezave të qytetit. Aty afër janë shtëpitë e Bujarit, i cili ka investuar bukur shumë aty. Sigurisht se pala duhet me marrë pëlqim nga banuesit aty. Përpos kësaj, nuk e dimë sesi ka me menaxhuar, se kjo është kompani private. Ne kemi pak informata për këtë çështje.

z. Kadri Krivenjeva: Edhe unë jam rritur aty, dhe e di ku janë vendbanimet. Lokacioni është të pjesa ende pa arritur të varrezat e qytetit. Shtëpitë e Bujarit janë larg nga aty.

Nënkryetar i Komunës: Lokacioni është të pjesa kah shkojmë për Stagovë.

znj. Ardita Rrahmani: Individit e ka ofruar atë pronë, në anën tjetër, komuna mundet mos me arritur marrëveshje më të.

z. Ramadush Osmani: Ne me ligj për mbeturina, mundemi me caktuar lokacionin, mënyra e menaxhimit është proces tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi fillimisht shkon në shqyrtim të ligjmerisë, ndërkaq për mënyrën e menaxhimit, ka ligj specifik për këtë punë. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë me ia adresuar KK dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimin për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave të demolimit të objekteve ndërtimore (mbeturinat inerte). Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:10. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e 12 e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 24.12.2024, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

